

## **K O M E N T**

### **Pershendetje.**

Me VKM nr.809 date 26.12.2018 paga minimale per vitin 2019 ka ndryshuar nga 24.000 leke ne 26.000 leke

Paga maksimale, ne baze te ligjit 7703 date 11.05.1993, neni 10 "Masa e Kontributit, indeksohet në të njëjtën kohë dhe në atë masë që indeksohet paga minimale në shkallë vendi.

Mbi kete baze kemi:

Paga minimale ishte 24.000 leke - behet 26.000 leke - rritja 2.000 leke ose 8.3333 %

Paga maksimale ishte 105.850 leke - behet 114.671 leke - rritja 8.821 leke ose 8.3333%

Perfundimisht kufijte e pages per llogaritjen e kontributit te sigurimeve shoqerore per vitin 2019 do te jene:

**Paga minimale 26.000 leke**

**Paga maksimale 114.671 leke**

*Ligji 7703, datë 11.5.1993*

*Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë*

*Neni 10*

*Masa e kontributeve*

*Kontributi që paguhet për sigurimet shoqërore në fondet e sigurimeve për sëmundje, barrë lindje dhe pensione do të jetë:*

*a) për punëdhënësit 13,8 për qind e shumës bruto të listëpagesave;*

*b) per personin e punësuar 9,5 për qind e pagesës së tij totale (bruto);*

*Kontributi llogaritet dhe paguhet mbi pagën bruto, brenda kufijve të pagës minimale në shkallë vendi dhe pagës maksimale për efekt kontributi për sigurimet shoqërore, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, e cila është në fuqi në datën 31.12.2014. Pas datës 1.1.2015, **paga maksimale për efekt kontributi indeksohet në të njëjtën kohë dhe në atë masë që indeksohet paga minimale në shkallë vendi.***

*Kontributi minimal për personin e punësuar, punëdhënësin dhe të vetëpunësuarin është i barabartë dhe llogaritet mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi.*

*Personat e vetëpunësuar në bujqësi paguajnë kontribut për pension dhe barrë lindje të llogaritur mbi pagën minimale në shkallë vendi. Pagesa e kontributit bëhet çdo tremujor.*

*Ndryshuar neni me ligjin nr.104/2014 date 31.07.2014*